



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 768/3 Prot

Tiranë, më 17.11.2021

V E N D I M

Nr.144, datë 17.11.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së procesit të konkurrimit për ngritje në detyrë, kodi # 3637, të zhvilluar për pozicionin e punës, “Përgjegjës i Sektorit të Programimit dhe Publikimeve, në Drejtorinë e Programim Zhvillimit”, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (kategoria III-a/1).

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

Vërej se:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 768 prot., datë 25.08.2021, konkurrentja ***** , aktualisht specialiste në institucionin Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, ka ngritur pretendimin se gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit për lëvizje paralele/ ngritje në detyrë në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese, kodi #3637, për pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Programimit dhe Publikimeve”, në Drejtorinë e Programim-Zhvillimit, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, nga ana e Komitetit të Pranimit për Ngritjen në Detyrë, janë lejuar parregullsi në drejtim të saj, pasi nuk kanë vlerësuar si duhet rubrikën “vlerësimi i jetëshkrimit”, ndërsa nga ana tjetër njësia paraseleksionuese e Departamentit të Administratës Publike, në mënyrë të padrejtë ka kualifikuar kandidaten ***** , e cila zotëron një master që nuk ka lidhje me pozicionin apo fushat e tjera të gjeoshkencave, që mbulon institucioni.

Për verifikimin e pretendimeve të mësipërme, u shqyrtua gjithë dokumentacioni shkresor që administrohet prej njësisë së burimeve njerëzore të institucionit Shërbimi Gjeologjik Shqiptar për këtë procedurë konkurrimi.

Nisur nga përmbajtja e materialeve të administruara, rezulton se nëpunësja *****, ka aplikuar për të marrë pjesë në procedurën e konkurrimit për ngritje në detyrë në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Programimit dhe Publikimeve”, në Drejtorinë e Programim-Zhvillimit, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, i cili është shpallur rregullisht me kodin #3637, në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike.

Në shpalljen e këtij pozicioni, është vënë kusht që kandidatët të plotësojnë kriteret e posaçme si më poshtë:

- a) Të zotërojnë diplomë “*Master Shkencor*” apo “*Master Profesional*” të përfunduar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike në Gjeologji/ Inxhinieri Gjeologjike, profili “*Inxhinieri Gjeologjike dhe Hidrogjeologji/ Vendburimet e Mineraleve të Dobishme-Petrologji*”. Edhe diploma e nivelit “*Bachelor*” të jetë në të njëjtën fushë.
- b) Të ketë të paktën 2 vite përvojë pune në profesion.

Mbështetur në pikën 22, të kreut III, të vendimit nr. 242, datë 18.3.2015 “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, të ndryshuar, DAP, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur në dosjen elektronike, ka kryer verifikimin e plotësimit të kriterëve të posaçme nga secili kandidat.

Në përfundim të fazës së parë të konkurrimit, është çmuar se kandidatja *****, i përmbush kërkesat e posaçme për vendin e punës e për këtë arsye, ajo është kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të konkurrimit, që ka të bëjë me testimin me shkrim dhe vlerësimin e kandidatëve nga Komiteti i Pranimimit për Ngritje në Detyrë.

Mbështetur në parashikimet e pikës 27, të kreut III, të vendimit nr. 242, datë 18.3.2015 “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, i ndryshuar, në vlerësimin e kandidatëve që konkurrojnë për procedurën e ngritjes në detyrë, përfshihen:

- a) Vlerësimi i jetëshkrimit, që konsiston në vlerësimin e arsimit, përvojës e trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve individuale në punë;
- b) Vlerësimi i përgjigjeve me shkrim;
- c) Intervista e strukturuar me gojë.

Duke analizuar përmbajtjen e dokumentacionit të administruar, rezulton se në përfundim të konkurrimit, kandidatja *****, është vlerësuar me 15 pikë nga 20 të

mundshmet (në vazhdim 15/20 pikë) për dokumentet e dorëzuara; 40/40 pikë për testimin me shkrim dhe 40/40 pikë për intervistën e strukturuar me gojë. Në përfundim ajo është vlerësuar me 95 pikë gjithsej, duke u pozicionuar e dyta në renditjen e kandidatëve që janë vlerësuar mbi 70 pikë.

Vërehet se, vlerësimi për dokumentet e dorëzuara është shuma e vlerësimeve për rubrikat jetëshkrimi 5/5 pikë + arsimit 0/5 pikë + përvoja në punë 5/5 pikë + trajnimet të lidhura me fushën 3/3 pikë + vlerësimi për arritjet individuale në punë 2/2 pikë.

Rezulton që në datën 26.07.2021, brenda afatit ligjor, Departamenti i Administratës Publike, nëpërmjet e-mailit, ka njoftuar konkurrenten për rezultatin e pikëve të marra në këtë konkurrim.

Kërkuesja, shprehet se pas komunikimit të rezultatit të arritur prej 95/100 pikë, ka menduar se nuk ka qenë nevoja për tu ankuar, por kur ka rënë në dijeni të faktit që një kandidate tjetër (*****), ka rezultuar me 96/100 pikë, ankuesja ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë Departamentit të Administratës Publike në datën 30.07.2021.

Ajo ka pretenduar se nuk është dakord me vlerësimin në rubrikën “Arsimi” dhe se, kualifikimi i kandidates ***** , për të vazhduar konkurrimin ka qenë i padrejtë pasi kjo konkurrenca, nuk plotësonte kriteret e posaçme të kërkuara për këtë pozicion pune (arsimin dhe vjetërsinë në profesion).

Pavarësisht se është konstatuar që ankimi ishte ushtruar jashtë afatit të përcaktuar në pikën 35, të kreut III, të vendimit nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, Komiteti i Pranimit për Ngritje në Detyrë, në datën 16.08.2021 (pasi një pjesë e anëtarëve të KPND, ishin duke ushtruar të drejtën e pushimit vjetor), në ambientet e Departamentit të Administratës Publike, në prani të pesë anëtarëve, ka marrë në shqyrtim ankesën duke zhvilluar ballafaqim me ankuesen në lidhje me pretendimet e ngritura prej saj.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 4651/3 prot., datë 01.09.2021, “Kthim përgjigje”, ka sqaruar ankuesen se Komiteti i Pranimit për Ngritje në Detyrë, ka vlerësuar që kandidatja ***** , (ankuesja), zotëron diplomë të nivelit DIND, duke plotësuar kriterin e përcaktuar në shpalljen për konkurrim, ndërsa vlerësimi me pikë për këtë rubrikë jepet në ato raste kur kandidati zotëron arsim shtesë të pambaruar, arsim shtesë të mbaruar apo gradë shkencore të përfunduar. Për këtë arsye vlerësimi për arsimin mbetet 0 pikë. Në rubrikat “Trajnime” dhe “Përvoja në punë”, kandidatja ka patur tejkalim domethënës të kërkesave e për këtë arsye, është vlerësuar maksimalisht. Pra, në përfundim të shqyrtimit të ankesës KPND, ka mbetur në të njëjtin vlerësim.

Lidhur me pretendimin e ankueses se kandidatja *****, nuk mund të kualifikohej për pjesëmarrje në konkurrim pasi sipas saj, ajo nuk plotëson kriteret e posaçme lidhur me arsimin e lartë dhe përvojën në profesion, që duhet të zotërojnë kandidatët që aplikojë për këtë pozicion, rezulton se kjo kandidate ka kryer studimet në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, të Universitetit Politeknik të Tiranës, në degën Gjeologji Naftë e cila konsiderohet pjesë e shkencës gjeologjike.

Për sqarimin e mëtejshëm të këtij momenti, Departamenti i Administratës Publike, me qëllim verifikimin e plotësimit korrekt të kriterit arsimor të të përcaktuar në shpalljen #3736, për shkak të specifikave të tij, ka kërkuar nga institucioni, konfirmimin për përfshirjen e diplomave të kandidatëve në llojin e arsimit të kërkuar, të përcaktuar në shpallje.

Institucioni në përgjigjen e kthyer në rrugë elektronike, i ka konfirmuar Departamentit të Administratës Publike, se diplomat e kandidatëve plotësojnë kriterin e llojit të arsimit të kërkuar për pozicionin e shpallur.

Nga sa më sipër, Departamenti i Administratës Publike, ka sqaruar ankuesen se, në zbatim të nenit 26, të kreut V, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe pikës 22, të kreut III, të vendimit nr. 242, datë 18.3.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, për fazën e dytë të këtij konkurrimi, janë kualifikuar kandidatët që kanë përmbushur kushtet për procedurën e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Më tej, përsa i takon pretendimit të ankueses për vlerësimin e diplomave të kandidates *****, Departamenti i Administratës Publike, sqaron se KPND-ja, ka vlerësuar se arsimi shtesë që zotëron kandidatja (*Diplomë e Studimeve të Thelluara Pasuniversitare, MASTER në Shkencat Mjedisore*) përfshihet në pikën “arsimi shtesë i përfunduar”. Gjithashtu nga verifikimi i librezës së punës dhe kohëzgjatjes së punësimit në institucionin SHGJSH, kandidatja në fjalë, plotëson kriterin për përvojën në profesion.

Nisur nga gjithë sa më sipër, arrihet në përfundimin që pretendimet e paraqitura nga kandidatja *****, lidhur me vlerësimin e saj në procedurën e konkurrimit për ngritje në detyrë në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Programimit dhe Publikimeve”, në Drejtorinë e Programim-Zhvillimit, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, si dhe arsyet e kualifikimit të kandidates *****, janë trajtuar drejt nga Komiteti i Pranimit për Ngritje në Detyrë dhe njësia përgjegjëse, si nga pikpamja e afateve ligjore ashtu dhe nga pikpamja e përmbajtjes së tyre.

Duke qenë se veprimet e Komitetit të Pranimit për Ngritje në Detyrë dhe Departamentit të Administratës Publike, vlerësohen të kryera në përputhje me ligjin dhe

pretendimet e ngritura gjenden të pabazuara, hetimi administrativ i kësaj çështje konsiderohet i përfunduar.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; bazuar në nenin 90, të ligjit nr.44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe nenin 16, pika 6, të Rregullores, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së konkurrimit për ngritje në detyrë kodit # 3637, të zhvilluar nga DAP, për pozicionin e punës, *“Përgjegjës i Sektorit të Programimit dhe Publikimeve, në Drejorinë e Programim Zhvillimit”*, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (kategoria III-a/1).
2. Arkivimin e çështjes, së filluar në bazë të kërkesës së regjistruar me nr. 768 prot., datë 25.08.2021, paraqitur prej nëpunëses *****.
3. Të njoftohet për këtë vendim Departamenti i Administratës Publike, institucioni Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, si dhe nëpunësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha